

VENDIM
Nr. 91, datë 31.5.2019

MBI NJË NDRYSHIM NË “MARRËVESHJEN PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OSHEE SHA DHE FURNIZUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË MIRATUA ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 24, DATË 15.2.2017, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 58, DATË 15.4.2019

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; nenin 19, pika 2, të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a., dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, “Mbi ndryshimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, të miratua me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin e bordit nr. 24, datë 15.2.2017 miratoi “Marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin e bordit nr. 58, datë 15.4.2019,

- Në vijim të kësaj procedure, ERE ka miratuar një sërë marrëveshjesh ndërmjet OSHEE sh.a. dhe disa furnizuesve të energjisë elektrike, të tilla si:

- “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE sha me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k., miratuar me vendimin e bordit nr. 79, datë 6.4.2018.

- “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE sha, me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “KASTRATI ENERGY” sh.p.k., miratur me vendimin e bordit nr. 74, datë 10.5.2019,

- “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE sh.a., me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “GSA” sh.p.k.”, miratuar me vendimin e bordit nr. 77, datë 6.4.2018.

- “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE sh.a., me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “Grid Energy” sh.p.k., miratuar me vendimin e bordit nr. 111, datë 14.5.2018.

- “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE sh.a., me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “Albanian Energy Supplier” sh.p.k. (AES sh.pk.), miratuar me vendimin e bordit nr. 78, datë 6.4.2018,

- Neni 20.1 i marrëveshjes tip përcakton se:

“Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE”.

- Duke qenë se marrëveshjet me furnizuesit, si më sipër cituar, lidhen konform “marrëveshjes TIP” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.24, datë 15.2.2017, ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, është i panevojshëm miratimi rast pas rasti i të gjitha marrëveshjeve të lidhura mes OSHEE sh.a., dhe furnizuesve të licencuar në aktivitetin e furnizimit.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndryshimin e nenit 20, pika 1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a., dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, si më poshtë:

- 20.1 *“Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 dërgohet në ERE për dëjjen”.*

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti